



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 582 Akti

Nr. 382 Vendimi
Tiranë, më 6.5.2021

V E N D I M

Trupi gjykses i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu Kryesuese
Etleda Çiftja Relatore
Alma Faskaj Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 5.5.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Albert Murçaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Albert Murçaj, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Albert Murçaj është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Albert Murçaj, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 8.6.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret Suela Zhegu, Etleda Çiftja dhe Alma Faskaj.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 15.6.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Suela Zhegu. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 8.7.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi vendimin e trupit gjykues, datë 22.6.2020, për fillimin e procesit të rivlerësimit, e njoftoi mbi përbërjen e tij dhe i kërkoi subjektit të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni, gjithashtu, i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

6. Trupi gjykues, me vendimin, datë 22.4.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Albert Murçaj, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi

¹ E-mail datë 8.7.2020, ora 10:06, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Në datën 22.4.2021, përmes postës elektronike², trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 18.12.2020; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit iu kërkuua të paraqiste prova dhe shpjegime brenda datës 27.4.2021.

7. Në datën 23.4.2021 subjekti i rivlerësimit kërkoi kohë më të gjatë për të paraqitur shpjegimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit, kërkesë e cila iu pranua. Komisioni, përmes postës elektronike³, njoftoi subjektin e rivlerësimit se mund t'i dërgonte shpjegimet në përgjigje të rezultateve në datën 30.4.2021. Në datën 30.4.2021 subjekti i rivlerësimit paraqiti pretendimet e tij me shkrim dhe dokumentacionin justifikues bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht me anë të postës elektronike⁴.

8. Më tej, Komisioni njofton subjektin e rivlerësimit me anë të postës elektronike⁵ se trupi gjykues, me vendimin e datës 30.4.2020, vendosi të ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 5.5.2021, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe Kodit të Procedurave Administrative.

9. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Albert Murçaj, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Në datën 5.5.2021 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqiti personalisht në seancë.

² *E-mail*, datë 22.4.2021, ora 12:14 p.m. "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit".

³ *E-mail*, datë 26.4.2021, ora 11:12 "Kthim përgjigje dhe konfirmim e-maili".

⁴ *E-mail*, datë 30.4.2021, ora 11:06 "Dërgim shpjegimesh dhe konfirmim e-mail".

⁵ *E-mail*, datë 30.4.2021, ora 1:12 p.m. a.m. – "Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore publike".

11. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

12. Z. Albert Murçaj, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

13. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin Albert Murçaj, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

14. Seanca dëgjimore e datës 5.5.2021, u ndërpre, për të rifilluar në datën 6.5.2021, për shpalljen e vendimit.

15. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 5.5.2021, subjekti i rivlerësimit, z. Albert Murçaj, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit, z. Albert Murçaj, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

18. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

19. Referuar vendimit nr. 2/2017⁶, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të

⁶ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se:

mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

20. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Albert Murçaj, që është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2009, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

21. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2009 – 2016 dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, Vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, Vetting”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri në seancën dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

23. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të

“Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

24. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon:

24.1 Z. L.M. – babai i subjektit – konsiderohet person tjetër i lidhur si rezultat i përdorimit të banesës nga subjekti.

24.2 Znj. M.M. – nëna e subjektit – konsiderohet person tjetër i lidhur si rezultat i përdorimit të banesës nga subjekti.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Depozitë bankare kursimi në shumën 600.000 lekë

1.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë bankare kursimi në shumën 600.000 lekë në “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 31.12.2015, të realizuara nga të ardhurat nga paga, dieta dhe shpërblime si prokuror. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar: të ardhura nga paga, dietat dhe shpërblimet nga detyra e prokurorit dhe për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁷.

1.2 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se referuar dokumentacionit të administruar nga “Intesa Sanpaolo Bank”⁸ konfirmohet depozita bankare në shumën 600.000 lekë në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 27.1.2017. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë evidentohet se në datën 30.12.2015 subjekti ka kryer një depozitim në shumën 600.000 lekë dhe po në të njëjtën datë kjo shumë është kaluar për krijimin e depozitës. Konstatohet se në vitin 2015 të ardhurat kanë qenë në vlerën 1.259.589 lekë⁹, shpenzimet në vlerën 282.470 lekë¹⁰ dhe shtimi i likuiditeteve në vlerën 287.730 lekë¹¹, duke rezultuar me një balancë pozitive për këtë vit në shumën 689.389 lekë.

1.3 Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2010 – 2016, periudhë gjatë së cilës subjekti deklaroi kursime *cash* vjetore dhe në këtë analizë u evidentuan balanca vjetore pozitive për të gjithë periudhën e krijimit të kursimeve.

1.4 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari dhe ka burime të ligjshme me dokumentacion justifikues për krijimin e saj.

⁷ Vërtetim datë 17.10.2016, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, ku vërtetohet se z. Albert Murçaj disponon depozitë me gjendje në vlerën 600.000 lekë.

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 27.7.2020.

⁹ Referuar kreditimeve të pagës në “Raiffeisen Bank” dhe vërtetimit nr. ***, datë 21.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

¹⁰ Shpenzime jetike në shumën 224.276 lekë, shpenzime mobilimi në shumën 50.000 lekë dhe shpenzime *TIMS* në shumën 8.194 lekë.

¹¹ Shtimi i kursimeve *cash* në shumën 360.000 lekë, pakësim i kursimeve *cash* në shumën 600.000 lekë, shtim depozite bankare në shumën 600.000 lekë dhe pakësim i llogarive rrjedhëse bankare në shumën 72.270 lekë.

2. Depozitë bankare kursimi në shumën 300.000 lekë

2.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar depozitë bankare kursimi në “Credins Bank”, në datën 22.10.2016, të realizuara nga të ardhurat nga paga, dietat dhe shpërblimet si prokuror, në shumën 300.000 lekë. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar: të ardhura nga paga, dieta dhe shpërblime nga detyra e prokurorit. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹².

2.2 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se referuar dokumentacionit të administruar nga “Credins Bank”¹³ konfirmohet se subjekti disponon depozitë bankare në vlerën 300.000 lekë në datën 27.1.2017. Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë bankare evidentohet se në datën 22.10.2016 subjekti ka kryer një depozitim në vlerën 300.000 lekë.

2.3 Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2015 – 2016, gjatë së cilës subjekti deklaroi kursime *cash* vjetore. Në këtë analizë evidentohen balancat vjetore pozitive, dhe konkretisht konstatohet se në vitin 2015 të ardhurat kanë qenë në vlerën 1.259.589 lekë¹⁴, shpenzimet në vlerën 282.472 lekë¹⁵ dhe shtim i likuiditeteve në vlerën 287.730 lekë¹⁶, duke rezultuar me një balancë pozitive për këtë vit në shumën 689.387 lekë. Po kështu, gjatë vitit 2016 të ardhurat kanë qenë në vlerën 1.181.183 lekë¹⁷, shpenzimet në vlerën 297.590 lekë¹⁸ dhe ndryshimi i likuiditeteve në vlerën 413.640 lekë¹⁹, duke rezultuar me një balancë pozitive për këtë vit në shumën 469.953 lekë.

2.4 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari dhe ka burime të ligjshme me dokumentacion justifikues për krijimin e saj.

3. Kursime të tjera në gjendje *cash* në shumën 750.000 lekë

3.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar kursime të tjera në gjendje *cash* në shumën 750.000 lekë, të realizuara nga të ardhurat nga paga, dieta dhe shpërblime si prokuror. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar: të ardhura nga paga, dietat dhe shpërblimet nga detyra e prokurorit.

3.2 Pas analizimit të deklaratave periodike vjetore, Komisioni konstatoi se shuma e likuiditeteve *cash* në datën 30.12.2016, duket të ishte në shumën 1.230.000 lekë, ndërkohë që referuar deklaratës *Vetting*, plotësuar më 26.1.2017, gjendja e likuiditeteve *cash* ka qenë në shumën 750.000 lekë.

¹² Nxjerrje llogarie, datë 22.10.2016, nga “Credins Bank”, në emër të z. Albert Murçaj, me gjendje më 22.10.2016, në vlerën 300.000 lekë + mandat “Credins Bank”, datë 22.10.2016, ku z. Albert Murçaj ka depozituar shumën 300.000 lekë.

¹³ Shkresa nr. *** prot., datë 6.11.2020.

¹⁴ Referuar kreditimeve të pagës në “Raiffeisen Bank” dhe vërtetimit nr. ***, datë 21.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

¹⁵ Shpenzime jetike në vlerën 224.276 lekë, shpenzime mobilimi në vlerën 50.000 lekë dhe shpenzime sipas sistemit *TIMS* në vlerën 8.194 lekë.

¹⁶ Shtim i kursimeve *cash* në shumën 360.000 lekë, pakësim i kursimeve *cash* në shumën 600.000 lekë; shtim depozite bankare në shumën 600.000 lekë dhe pakësim i llogarive rrjedhëse bankare në shumën 72.270 lekë.

¹⁷ Referuar kreditimeve të pagës në “Raiffeisen Bank” dhe vërtetimit nr. ***, datë 21.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe vërtetimit nr. ***, datë 20.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

¹⁸ Shpenzime jetike në vlerën 235.092 lekë, shpenzime mobilimi në vlerën 50.000 lekë dhe shpenzime sipas sistemit *TIMS* në shumën 12.498 lekë.

¹⁹ Shtim i kursimeve *cash* në shumën 360.000 lekë, pakësim i kursimeve *cash* në shumën 300.000 lekë, shtim depozite bankare në shumën 300.000 lekë dhe shtim i llogarive rrjedhëse bankare në shumën 53.640 lekë.

3.3 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektivit në lidhje me konstatimin se *duket se ka mospërputhje ndërmjet gjendjes së deklaruar në datën 31.12.2016 (1.230.000 lekë) e bazuar në deklaratat periodike vjetore dhe gjendjes së deklaruar në datën 26.1.2017 në deklaratën Vetting (750.000 lekë).*

3.4 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, ka deklaruar se në lidhje me plotësimin dhe mospërputhjen e evidentuar nga Komisioni, vlerëson se lidhet me një lapsus të mospërfshirjes në këtë deklaratë të të ardhurave të vitit 2016, duke qenë se të ardhurat dhe interesat pasurore të vitit 2016 do të deklaroheshin në deklaratën vjetore deri në mars të vitit 2017. Këto të ardhura, megjithëse janë evidentuar nga subjekti në deklaratë, gabimisht nuk janë shtuar në gjendjen *cash* në deklaratën *Vetting* të vitit 2017. Nëse merret kjo shumë dhe shtohet tek gjendja *cash* e vitit 2016, në deklaratën *Vetting* shuma *cash* kalon nga 750.000 lekë në 1.110.000 lekë, ndërsa diferenca e nxjerrë nga Komisioni $1.230.000 - 1.100.000 = 120.000$ lekë është shumë e shpenzuar gjatë tetorit të vitit 2016 deri janar të vitit 2017.

3.5 Në gjendjen *cash* prej 750.000 lekësh duhej të ishte shënuar, përfshirë edhe të ardhurat e vitit 2016 (360.000 lekë), shuma prej 1.110.000 lekësh, që është shuma e saktë e likuiditeteve që subjekti disponon.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.6 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektivit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

3.7 Në shpjegimet e tij në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit pranoi se ka pasur një lapsus gjatë plotësimit të deklaratës *Vetting* nga ana e tij, pasi gjendjes së deklaruar prej 750.000 lekësh duhet t'i ishin shtuar edhe të ardhurat e vitit 2016 në shumën 360.000 lekë. Për rrjedhojë, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka plotësuar deklaratën *Vetting* në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me pikën 2 të udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive në pronësi, zotërim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon se: “*Data e dorëzimit, e shënuar në faqen 1 të deklaratës së pasurisë, duhet të përputhet me gjendjen e të dhënave të deklaruara në faqet e tjera të deklaratës së pasurisë*”.

3.8 Gjithsesi, vlen të theksohet se nga analiza financiare e kryer në Komision rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të përballuar të

gjitha shpenzimet e kryera prej tij dhe kursimet e krijuara me burim këto të ardhura, në secilin prej viteve në të cilin janë kryer deklaratimet periodike.

3.9 Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, i gjendur në parashikimet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2014, por në kushtet kur ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj shume të padeklaruar, sipas analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues çmon se kjo pasaktësi nuk mund të përbëjë e vetme shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

4. Lidhur me banesën e babait në përdorim

4.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme në pronësi ose në përdorim, por ka deklaruar si adresë të regjistruar në gjendjen civile: lagjja “***”, rruga “***”, nr. ***, Bashkia Shkodër.

4.2 Në pyetësonin standard²⁰ subjekti deklaroi se para fillimit të detyrës e në vijim ka pasur një adresë vendbanimi në qytetin e Shkodrës, ku edhe ka lindur, konkretisht, lagjja “***”, rruga “***”, më vonë e ndryshuar në rrugën “***”, banesë private nr. ***, e ndryshuar në nr. ***, me sistemin e ri të adresave të Bashkisë Shkodër, por është e njëjta banesë. Subjekti ka bashkëlidhur certifikatën e pronësisë në emër të babait të tij, z. L.M., pronë me sip. 174 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

4.3 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se ASHK-ja Shkodër²¹ konfirmon se kjo banesë është në pronësi të shtetasit L.M., babai i subjektit. Referuar dokumentacionit të përcjellë për origjinën e pronës²² rezulton se regjistrimi është bërë në përputhje me ligjin nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe VKM-në nr. 745, datë 24.10.2012, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”.

4.4 Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1²³, i kërkoi subjektit të vendosë në dispozicion pozicionin e saktë (me koordinata) të këtij objekti në *google maps* dhe foto nga jashtë të tij, si dhe të deklarojë nëse janë kryer investime në objekt nga viti 2009 e në vijim, e nëse po, sa ka qenë vlera e tyre.

4.5 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1²⁴, subjekti sqaron se nga viti 2009 e në vijim nuk dinte të kishte pasur investime në këtë banesë. Ka pasur vetëm shpenzime normale

²⁰ E-mail datë 8.7.2020, ora 10:06.

²¹ Shkresa nr. *** prot., datë 9.9.2020.

²² (1) Kartelë e pasurisë së paluajtshme e pasurisë ***, e llojit “ndërtesë”; (2) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.9.2015; (3) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.9.2015; (4) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.9.2015; (5) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.9.2015; (6) vërtetim nga Njësia Administrative Nr. ***, Shkodër; (7) planimetri e viteve 1962 - 1981; (8) vërtetim nr. ***, datë 23.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; (9) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.3.2017; (10) shkresë nr. *** prot., datë 6.2.2017 e ZVRPP-së Shkodër; (11) hartë treguese e pasurisë nr. ***; (12) planimetri e brendshme e shtëpisë së z. L.M.; (13) shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2017 e Bashkisë Shkodër; (14) vërtetim pronësie datë 20.4.1993 e Zyrës së Hipotekës Shkodër e njehsuar me origjinalin nga noteri; (15) urdhër nr. *** prot., datë 17.5.2017, i ZVRPP-së Shkodër; (16) relacion teknik hartografik për afishim publik; (17) plan rilevimi i datës 21.11.2015; (18) relacion i datës 17.5.2017 i ZVRPP-së Shkodër; (19) vendim nr. ***, datë 17.5.2017, i ZVRPP, Shkodër; (20) Kopje nga regjistri i hipotekës, (21) certifikatë pronësi e pasurisë ***, e familjes Sh.; (22) hartës treguese të pasurisë nr. ***; (23) certifikatë pronësie e pasurisë nr. ***, në pronësi të z. L.M.; (24) hartë treguese e pasurisë nr. ***; (25) kartelë e pasurisë së paluajtshme e pasurisë nr. ***, e llojit ndërtesë; (26) kartelë e pasurisë nr. ***; (27) kartelë e pasurisë nr. *** në pronësi të familjes Sh.

²³ E-mail datë 2.4.2021, ora 12:10.

²⁴ E-mail datë 8.4.2021, ora 12:30.

mirëmbajtjeje vjetore si, lysterje apo rregullime të vogla që lidhen me lysterjen dhe me amortizimin normal. Por, nuk ka pasur investime në kuptim të vlerave të konsiderueshme financiare apo rikonstrukcion të saj. Subjekti vuri në dispozicion foto nga *google maps*, koordinatat gjeografike dhe foto të objektit nga jashtë, nga ku Komisioni nuk konstaton problematika lidhur me këtë objekt.

4.6 Nga hetimi i Komisionit nuk u konstatuan *indicie* apo prova të cilat të vërtetonin se subjekti i rivlerësimit ka lidhje me krijimin e kësaj pasurie apo të ndonjë investimi gjatë kohës së qenies në detyrë.

4.7 Si konkluzion, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë përdorimin e kësaj pasurie, personat e tjerë të lidhur kanë pasur burime të ligjshme për krijimin e saj dhe subjekti nuk ka fshehur apo deklaruar jo saktë këtë pasuri.

5. Lidhur me adresat e banimit ndër vite

5.1 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se në DIPP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar si vendndodhje rrugën “***”, Durrës, ndërsa në pyetësonin standard ka deklaruar se në periudhën dhjetor 2009 – shtator 2010 ka përdorur kundrejt qirasë banesën apartament të ndodhur në Lagjen nr. *** pranë shkollës se mesme “***”, Durrës, pronë e shtetasve P. dhe K.M., e lëshuar me qira nga vëllai i tij (P.), shtetasi R.M., që e kishte në zotërim në atë kohe, pasi pronarët ndodheshin jashtë shtetit. Banesa është marrë me qira me kolegun tij, 50% me 50%, në shumën 14.000 lekë/muaj, pra 7.000 lekë secili. Subjekti shpjegoi se duke qenë se marrëveshja ishte më pak se një vit dhe se personi nuk ishte pronari i banesës që do të merrej me qira, nuk është bërë kontrate qiraje me shkrim. Për vërtetimin e këtij deklarimi subjekti paraqiti deklaratën noteriale të shtetasit R.M.²⁵

5.2 Në DIPP-të e viteve 2009 dhe 2010 subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e banesës në Durrës.

5.3 Më anë të pyetësonit nr. 1²⁶, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me këtë mospërputhje.

5.4 Në përgjigje të pyetësonit nr. 1²⁷, subjekti shpjegoi se deklarata para fillimit të detyrës në vitin 2009 dhe deklarata e interesave private periodike vjetore e vitit 2009 kanë qenë herët e para që ka plotësuar këto deklarata dhe duke mos qenë i njohur shumë mirë me këto detyrime, plotësimi është bërë duke pyetur kolegët. Subjekti sqaron se në deklaratën paraprake të bërë në nëntor të vitit 2009 nuk e kishte marrë me qira banesën e cituar më sipër. Duke qenë se kërkohej një adresë në deklaratën paraprake kishte vendosur adresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që ndodhet në rrugën “***”, Durrës, edhe për faktin se nuk kishte adresë tjetër kontakti në Durrës. Pasi kishin marrë shtëpinë me qira me kolegun dhe pasi kishin bërë deklaratën vjetore të vitit 2009 në mars të 2010-ës, kishte deklaruar përsëri vendndodhjen në rrugën “***”, Durrës, pra, adresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi ishte adresë më e saktë dhe më e njohur se adresa e banesës me qira dhe mund të ngatërrohej në rastet e postës apo të njoftimeve.

²⁵ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.7.2020.

²⁶ E-mail datë 2.4.2021, ora 12:10.

²⁷ E-mail, datë 8.4.2021, ora 12:30.

5.5 Në DIPP-të e viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013 subjekti ka deklaruar si adresë qëndrimi: lagjja “***”, Bajram Curri, Tropojë. Në pyetësonin standard ka deklaruar se gjatë periudhës nëntor 2010 – maj 2014 ka qëndruar në godinën e ish-Hetuesisë Tropojë, ku ka pasur një dhomë pa shpërblim apo pa qira, për shkak të detyrës si prokuror. Për të provuar deklaratimet e tij subjekti paraqiti vërtetimin nr. ***, datë 13.7.2020, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

5.6 Në DIPP-të e vitit 2014, 2015 dhe 2016 subjekti ka deklaruar adresën e gjendjes civile (shtëpinë e babait në Shkodër) dhe nuk ka deklaruar adresë vendqëndrimi. Gjatë periudhës nëntor 2013 – janar 2016 subjekti ka punuar në Pukë.

5.7 Si konkluzion, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me adresat e deklaruara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit, për efekt të procesit të rivlerësimit.

6. Gjetje të tjera

Në lidhje me deklarinimin e llogarive bankare

6.1 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”²⁸ konstatohet se në datën 26.1.2017 (data e plotësimit të deklaratës *Vetting*), subjekti ka pasur gjendje likuiditetesh në llogari bankare, të cilat nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*, konkretisht llogari bankare në lekë (e pagës) në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 79.814 lekë dhe llogari bankare në euro në po të njëjtën bankë, në vlerën 1,17 euro.

6.2 Më tej, në deklaratat periodike vjetore subjekti nuk ka deklaruar ndër vite llogaritë bankare në emër të tij.

6.3 Komisioni vëren se bazuar në germën “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, subjekti dhe personat e lidhur mbartin detyrimin të deklarojnë vlerën e likuiditeteve në llogari rrjedhëse në lekë ose në valutë të huaj.

6.4 Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁹, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se llogaria bankare në lekë (e pagës) në “Raiffeisen Bank” është deklaruar zyrtarisht që në deklarinimin e parë në vitin 2009 (është e njëjta llogari e hapur në vitin 2006 ose 2007 dhe e pandryshuar edhe sot) dhe në vijimësi çdo vit në deklaratat vjetore, ashtu si në deklaratën *Vetting* ka deklaruar këtë llogari ku janë derdhur të ardhurat e tij. Kjo është llogaria që ka shërbyer për hedhjen e pagës dhe të ardhurave të tjera nga puna si prokuror në prokuroritë ku ka punuar. Llogaria është rrjedhëse dhe ndryshon sa herë kryen veprime me të. Gjithashtu janë kryer tërheqje dhe pagesa të tjera nga kjo llogari, në çdo kohë dhe gjatë muajit ka pasur vlera të ndryshme. Sikurse dhe në janar të vitit 2017, ka pasur së paku 4-5 lëvizje dhe nuk mund të kishte një vlerë fikse që të shënohej në deklaratën *Vetting*. Edhe llogaria në euro ka qenë e lidhur pikërisht me këtë llogari në lekë që është hapur në vitin 2010. Në vijim, nga viti 2010 nuk ka kryer asnjë veprim tjetër me këtë llogari. Në këto rrethana e ka vlerësuar të panevojshme evidentimin e saj. Për më tepër, në kushtet e mospërdorimit të saj, e ka harruar dhe e ka vlerësuar të pavlerë rideklarinimin e saj. Edhe vlera prej 1,17 euro ose rreth 150 lekë të reja nuk mund të përbëjë pasuri për

²⁸ Shkresë nr. ***, datë. 24.7.2020.

²⁹ E-mail datë 30.4.2021, ora 11:06.

t'u konsideruar. Kjo llogari duke qenë se nuk është përdorur nga viti 2010 dhe duke vlerësuar se ishte e lidhur me llogarinë në lekë nuk është saktësuar në deklaratën *Vetting*.

6.5 Si konkluzion, Komisioni vlerëson se mbetet i pandryshuar konstatimi për mosdeklarimin e këtyre llogarive, por duke qenë se nuk sjellin pasojë për procesin e rivlerësimit apo në deklaratën *Vetting*, Komisioni vlerëson se ky mosdeklarim ndër vite nuk përbën shkak për shkarkim.

7. Automjet në përdorim

7.1 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se nga kontrollit në AMF subjekti i rivlerësimit rezulton përdorues i automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, vit prodhimi 1987, konkretisht për policat e prera në datat 3.10.2010, 13.11.2011 dhe 15.11.2012. Referuar këtyre policave, pronar automjeti figuron babai i subjektit L.M. Nga shqyrtimi i DIPP-ve të viteve 2010, 2011 dhe 2012 subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e tij. Gjithashtu, DPSHTRR-ja³⁰ nuk konfirmon automjete në emër të babait të subjektit të rivlerësimit.

7.2 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur në pyetësorin standard³¹ nëse gjatë periudhës së deklaramit ka përdorur pasuri të regjistruara në emër të dikujt tjetër (ndër të tjera edhe automjete), nuk e ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti.

7.3 Nga faktet e analizuarra më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në DPV-të e viteve 2010, 2011 dhe 2012; dhe (ii) nuk është e qartë pronësia e këtij automjeti të përdorur nga subjekti (subjekti i rivlerësimit të paraqesë kopje të dokumentacionit të pronësisë të këtij automjeti).

7.4 Në përgjigje të rezultateve të hetimit³², subjekti i rivlerësimit shpjegoi se automjeti me targa *** (“Mercedes-Benz”, viti 1987) është blerë nga babai dhe vëllai në vitin 2010. Automjeti është blerë me kontratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.6.2010, për shumën 200.000 lekë. Këtë automjet babai i tij ia ka dhënë në përdorim vëllait N.M. me kontratën e përdorimit nr. *** rep., datë 25.5.2010. Rreth vitit 2013 ky automjet ka pësuar defekt në motor dhe nuk është vlerësuar me leverdi për rregullim dhe nuk është nxjerrë më në qarkullim. Subjekti sqaron se nuk e ka pasur në përdorim këtë automjet dhe nuk ka akt përdorimi. Emri i subjektit figuron në policat e sigurimit TPL që janë bërë në vitet 2010 - 2012. Në policat e sigurimit shënohet si rregull emri i pronarit dhe përdoruesit, por në praktikë shënohen dhe emrat e tjerë të familjes së pronarit me qëllim që mund të drejtojnë automjetin dhe të mos përjashtohen nga mbulimi i sigurimit personat që mund ta drejtojnë dhe nuk janë pronarë. Subjekti sqaron se në policat e sigurimit mund të shënohen deri në 3 emra të ndryshëm. Emri i subjektit është shënuar me qëllim që teorikisht mund të përdorej nga ana e tij, nëse do të dëshironte. Për më tepër, në vitet 2010 - 2012 nuk ka punuar në Shkodër, por ka qenë me punë në Durrës dhe në Tropojë, ku dhe praktikisht nuk mund ta përdorte dhe kjo është arsyeja e mosdeklarimit.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 8.7.2020.

³¹ E-mail datë 8.7.2020.

³² E-mail datë 30.4.2021, ora 11:06.

Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti paraqiti kopjen e kontratës së shitblerjes së automjetit dhe të kontratës së përdorimit, me përdorues N.M. (i vëllai)³³.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

Subjekti i rivlerësimit provoi pronësinë e këtij automjeti në emër të babait dhe me anë të kontratës së shitblerjes së datës 21.6.2010 u analizuan mundësitë e babait për ta blerë në vitin 2010 dhe rezultoi se personi tjetër i lidhur/babai ka pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti³⁴.

Si konkluzion, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht mosdeklarimit gjatë viteve dhe shpjegimeve për këtë mosdeklarim, nuk ka pasur si qëllim fshehjen, duke qenë se marrëdhënia e tij me këtë automjet ka qenë me raste të veçanta dhe personi i lidhur/babai ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit.

Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare, duke konsideruar të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë për subjektin e rivlerësimit, paraqitur e përmbledhur në vijim:

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime
2007-2008	0	0	36,849	659,926	0	359,965	263,112
2009	0	0	-22,790	502,248	0	143,620	381,418
2010	0	220,000	6	846,435	0	204,702	421,727
2011	0	290,000	24,701	1,207,806	0	168,844	724,262
2012	0	300,000	1,275	1,066,289	0	171,407	593,607
2013	0	280,000	-16,802	1,018,037	0	165,437	589,402
2014	0	320,000	53,999	1,252,057	0	274,201	603,856
2015	0	-240,000	527,730	1,259,589	0	282,470	689,389
2016	0	60,000	353,640	1,181,183	0	297,590	469,953
TOTAL	-	1,230,000	958,608	8,993,570	-	2,068,236	4,736,726

Në konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues për të krijuar pasuritë dhe për të kryer shpenzimet gjatë periudhës së procesit të rivlerësimit.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

³³ (1) Kontratë shitblerjeje pasuri e luajtshme automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.6.2010; (2) kopje të kontratës së përdorimit nr. *** rep.

³⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 13.7.2020, e ISSH-së.

Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

Komisioni, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij. Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Albert Murçaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

25. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

26. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 4.8.2020, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 4.8.2020, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

27. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, z. Albert Murçaj: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Albert Murçaj.

28. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga DSIK-ja, Komisioni kreu hetim administrativ, prej të cilit rezultoi se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

29. Më tej, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës, nuk ka të dhëna të tjera që të rezultojë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

30. Nga hetimi administrativ i Komisionit nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

31. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe të vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit, z. Albert Murçaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

32. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

33. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

34. Prokuroria e Përgjithshme, si organ ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional, si vijon:

35. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

36. Ky vlerësim është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, së bashku me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin, të paraqitura nga subjekti; pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënave nga 23 prokuroritë pranë gjykatës së shkallëve të para, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyrës së Informacionit të Klasifikuar, Sektorit të Protokoll-Arkivit, si dhe burimeve arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

37. Subjekti në periudhën 12.10.2009 – 2.11.2010, ka ushtruar funksionin e prokurorit në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në nëntor të vitit 2010 është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë deri në nëntor të vitit 2013. Në nëntor të vitit 2013 është komanduar drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë deri në mars të vitit 2014. Në mars të vitit 2014 është komanduar përsëri drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë deri në korrik të vitit 2014. Në maj të vitit 2014 subjekti është transferuar prokuror në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe në qershor të vitit 2014 është caktuar drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Në shkurt të vitit 2016 është transferuar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në maj të vitit 2016 është emëruar zëvendësdrejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga prilli i vitit 2020 e në vijim ushtron përkohësisht detyrën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Albert Murçaj, ka aftësi të mira në kuptimin dhe interpretimin e legjislacionit në fuqi. Ai përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e tij në rastin konkret. Subjekti ka njohuri të mira rreth parashikimeve të normave të Kodit Penal dhe instituteve të së drejtës penale. Po kështu, shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të normave të Kodit të Procedurës Penale.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij kanë shtjellim të qartë dhe të kuptueshëm, duke u bazuar në analizë të normave juridike të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas formularit të vetëdeklarimit rezulton se subjekti Albert Murçaj ka deklaruar se në 3 vitet e periudhës së rivlerësimit ka pasur gjithsej 470 çështje penale, nga të cilat 386 procedime dhe 84 kallëzime penale. Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Albert Murçaj ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara pa dëmtuar cilësinë e vendimmarrjes.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Albert Murçaj, rezulton se ka përballuar ngarkesë pune voluminoze me cilësi dhe shpejtësi.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga gjetjet në procedimet penale të shortuara rezulton se subjekti ka administruar në mënyrë të shpejtë dhe efikase ngarkesën e punës që i është caktuar.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas dosjeve të vëzhguara dhe të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen problematika lidhur me etikën në punë të subjektit të rivlerësimit, z. Albert Murçaj.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Albert Murçaj, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me integritetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Albert Murçaj. Nuk janë konstatuar elementë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të paanshmërisë.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna të caktuara që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk evidentohen problematika në bashkëveprimin e subjektit të rivlerësimit gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e prokurorit.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti Albert Murçaj, në periudhën e rivlerësimit, ka marrë pjesë në 5 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

38. Nga tri dokumentet e paraqitura nga subjekti sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi shpjegime në lidhje me dokumentin nr. 1 “Konkluzione për gjykimin penal nr. *** të vitit 2012”, pasi nga shqyrtimi i tij krijohet dyshimi se hetimet janë zgjatur tej afateve të përcaktuara në nenin 263 të Kodit të Procedurës Penale.

39. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, deklaroi se afatet e hetimit kanë qenë 8 muaj e gjysmë dhe jo 2 vjet e 5 ditë. Me dërgimin e çështjes për gjykim përfundojnë afatet e hetimore dhe fillojnë afatet e gjykimit. Kjo çështje nuk është hetuar prej tij, por nga një prokuror tjetër dhe se këtë çështje e ka marrë në dhjetor të vitit 2013, kur kishin përfunduar hetimet dhe çështja ndodhej në gjykim. Në vijim, sqaroi se zgjatja e afateve hetimore dhe të paraburgimit nuk ka qenë kompetencë e tij, ndërsa në fazën e gjykimit është gjykata ajo që kontrollon afatet e gjykimit dhe të paraburgimit.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti dha shpjegime të mjaftueshme.

40. Nga pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimi për sa vijon:

40.1 Në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2014, i regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, për veprën penale “mbajtje pa leje e armëve luftarake”, për të cilën ishte vendosur pushimi i procedimit penal, pasi krijohet dyshimi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte kryer të gjitha veprimet hetimore para se të merrte vendimin e pushimit.

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, deklaroi se pyetja e shtetasit D. Z. nuk u bë e mundur nga policia gjyqësore dhe, në vijim, nuk u vlerësua si e domosdoshme, pasi në kushtet kur nuk u gjetën armë zjarri, armë të ftohta, armë gjuetie, pjesë të armëve të zjarrit, gëzhoja, predha apo municion luftarak, dëshmitë e personave nuk do të provonin faktin e dyshuar dhe nuk kishin asnjë vlerë prove në mundësinë e ngritjes së një akuze ndaj shtetasit N. N. Ky është një standard i kërkuar për veprën penale konkrete (neni 278 e vijues i Kodit Penal). I njëjti arsyetim vlen edhe për djalin e shtetasit D. Z.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti dha shpjegime të mjaftueshme.

40.2 Në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2013, i regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, për veprën penale “ndërtimi i paligjshëm”, pasi krijohet dyshimi se mungonte vendimi për zgjatjen e afateve hetimore.

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, deklaroi se procedimi penal është regjistruar nga një prokuror tjetër dhe është regjistruar pa autor të njohur. Në këto kushte, nuk ka vend për të marrë vendim për zgjatje të afateve hetimore.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti dha shpjegime të mjaftueshme.

Të dhëna nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme

41. Nga verifikimi në arkivën e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton që ndaj subjektit Albert Murçaj nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Në arkivën e Prokurorisë së Përgjithshme u gjet një vlerësim i Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin Albert Murçaj, që i përket punës së tij për vitin kalendarik 2016, vlerësuar “shumë mirë”.

42. Bazuar në përgjigjet e ardhura nga prokuroritë e rretheve gjyqësore rezulton se ndaj subjektit Albert Murçaj janë regjistruar dy kallëzime penale, përkatësisht njëri në Prokurorinë për Krimet e Rënda Tiranë dhe tjetri në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Materiali i parë kallëzues është regjistruar në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë, dërguar për kompetencë nga Prokuroria e Përgjithshme. Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, bazuar në nenin 290, pika 1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale, me arsyetimin se fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.

43. Lidhur me kallëzimin e dytë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka konstatuar se veprimet e prokurorit kanë qenë në përputhje me ligjin dhe për këtë arsye është vendosur mosfillimi i procedimit penal bazuar në nenin 190, pika 1, germa “ç”, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

44. Në sekretarinë e Prokurorisë së Përgjithshme, nga verifikimi manual prej vitit 2006, rezulton të ketë katër ankesa ndaj subjektit Albert Murçaj.

45. Komisioni, pasi mori në shqyrtim kallëzimet penale, vlerësoi se nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

46. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Albert Murçaj, janë administruar 4 denoncime nga publiku.

46.1 Në dy prej këtyre denoncimeve, në të cilat ngrihen pretendime për vendimin e pushimit e çështjes penale, Komisioni vlerësoi se nuk përmbanin fakte apo rrethana që mund të përbënin prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit të subjektit, respektivisht: (1) denoncimi nr. *** prot., datë 23.2.2021, i shtetasit A. B.; (2) denoncimi nr. *** prot., datë 23.3.2021, i shtetasit Gj. Sh.

46.2 Lidhur me denoncimin nr. *** prot., datë 10.1.2019, të shtetasit F. Gj. rezulton se ankuesi nuk ka sqaruar lidhur me procedimin penal që ka ndjekur subjekti i rivlerësimit, si dhe nuk ka bashkëlidhur dokumentacion në mënyrë që Komisioni të bënte verifikimet e nevojshme.

46.3 Lidhur me denoncimin nr. ***, datë 9.1.2018, të shtetasit Z. P. për çështjen me objekt “bashkimin e dënimeve”, Komisioni vlerësoi se nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbënin prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit të subjektit.

46.4 Në përfundim, Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

Si konkluzion, Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Albert Murçaj, është “i aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjyqësor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, Albert Murçaj, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Për këto arsye,

Trupi gjyqësor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Albert Murçaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ndaj këtij vendimi, me përjashtim të pikës 2, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Vendimi u shpall në Tiranë, më 6.5.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Alma Faskaj
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj